



## Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit Permanent Tribunal of Arbitration

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit  
Oda Ekonomike e Kosovës  
Permanent Tribunal of Arbitration  
Kosova Chamber of Commerce

Zyra Nr.22, Nëna Terezë, Nr.20,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 780 313  
Fax: +381(0) 38 224 299  
info@kosovo-arbitration.com  
www.kosovo-arbitration.com

### PËRMBLEDHJA E RASTIT TË ARBITRAZHIT

#### TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Përmbledhja e fakteve.....	1
2.	Vlerësimi ligjor .....	2
(a)	Jurisdikcioni I Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit .....	2
(b)	Forma e kontratës.....	2
(c)	Çështjet e pagesës.....	3
3.	Vendimi.....	4

#### 1. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

I padituri është fondacion i pavarur që ka marrë grante nga Banka Botërore për projektin “Përfshirja Sociale dhe Zhvillimi Lokal”. Banka Botërore ka ftuar ndërmarrësit e rinjë dhe ekzistues që të zhvillojnë bizneset e tyre duke aplikuar për grante për zhvillimin e bizneseve. Qëllimi i granteve ishte financimi i makinerisë, mjeteve të punës apo ndonjë trajnim i specializuar që zhvillon biznesin dhe gjeneron punësim. Përveq kritereve të tjera për marrjen e grantit, nga ndërmarrësit është kërkuar që të plotësojnë edhe këto dy kritere: 1) të kontribuojnë personalisht së paku 20% të kostos së projektit dhe 2) pajisjet duhet patjetër të jenë të reja, të papërdorura dhe me garancion minimum 12 muaj.

Më 28.09.2012, paditësi “Kompania A”, një ndërmarrje që ka për specializim prodhimin dhe instalimin e roletneve, në cilësi të përfituesit të grantit ka lidhur një kontratë me dhënësin e grantit “Kompania B” për projektin “Prodhimi i roletneve (venecianeve)” me çmim total 11,787.93€. Në çmimin total, më 9,137.93€ ka kontribuar i padituri në formë të grantit, ndërsa si përfitues ka kontribuar më 2,650.00 €. Po këtë ditë, paditësi ka depozituar kontributin personal për kontratën në llogari të të paditurit.

Më 01.10.2012, I padituri, në cilësinë e blerësit, ka lidhur kontratë mbi furnizimet me Kompaninë C, si furnitor, për blerjen e një makine për prodhimin e roletneve veneciane me çmim total prej 13,250.00 €.

Më 13.11.2012, Komisioni për pranim të pajisjeve ka inspektuar makinën për prodhimin e roletneve veneciane dhe ka gjetur se makina ka qenë e vjetër dhe e përdorur, dhe, si e tillë, nuk është në përputhje me kontratën e nënshkruar me datën 28.09.2012.

Më 29.11.2012, I padituri e ka lajmëruar me shkrim paditësin se e anulon kontratën e datës 28.09.2012, duke u mbështetur në nenin 2.12 të saj, ku thuhet: “në rast se përfituesi pranon nga furnitori pajisjen e cila është e vjetër, atëherë Fondi do ta ndëshkojë përfituesin me 10% të shumës së bashkëfinancimit të deponuar në llogaritë bankare. Më 18.01.2013, i padituri me anë të një shkrese I ka kërkuar paditësit numrin e llogarisë bankare për kthimin e kontributit të paguar. Paditësi nuk i është përgjigjur kësaj shkreseje duke mos i treguar llogarinë bankare për kthimin e mjeteve 10% nga shuma e deponuar si kontribut personal i paditësit në vlerë prej 2.650,00 € , në blerjen e makinerisë, siq ishte e specifikuar në aplikacion dhe në kontratë.

Më 20.02.2013, paditësi ka deponuar padi në Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit (TPA), pranë Odës Ekonomike të Kosovës, kundër të paditurit, për rivendosjen e gjendjes para shkëputjes së kontratës dhe për kompensimin e fitimit të humbur në shumë prej 3,000.00 €. Me nenin 6.1 të kontratës, palët janë dakorduar që në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti lidhur me këtë kontratë, do të vendoset miqësisht përmes negociatave në mes të palëve. Në rast se negociatat janë të pasukseshme, kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë arbitrazhi pranë Odës Ekonomike të Kosovës.

Më 22.05.2013, paditësi ka deponuar kërkesën që TPA t'i lejoj personit A që t'i bashkohet arbitrazhit si palë, pasi ky, gjatë gjithë kohës, ka qenë pikë kontaktuese në mes të paditurit dhe paditësit. I padituri e ka kundërshtuar kërkesën për lejimin e bashkimit në arbitrazh si palë të personit A. TPA, mbështetur në nenin 17.5, e ka refuzuar kërkesën që personit A t'i lejohej bashkimi si palë në arbitrazh, meqë personi A nuk është palë në marrëveshje dhe kontratë.

## **1. VLERËSIMI LIGJOR**

### **a) Jurisdiksioni I Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit**

Tribunali i Arbitrazhit ka konstatuar se ka jurisdiksion për të vendosuar mbi padinë e ngritur nga ana e paditësit, në bazë të rregullave të arbitrazhit në Kosovë të vitit 2011. Kjo në bazë të nenit 6.1 të kontratës e cila përcakton, qëndrimin e palëve që për çdo çështje kontestuese që mund të lind nga kjo kontratë, për zgjidhjen e tyre të jetë kompetente TPA. Tribunali i Arbitrazhit poashtu ka konfirmuar që gjuha që do të përdoret në arbitrazh do të jetë gjuha shqipe dhe vendi i arbitrazhit për shqyrtimin e kësaj çështje do të jetë Prishtina.

### **b) Forma e kontratës**

Tribunali i Arbitrazhit ka konstatuar se paditësi nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese paraparë me nenin 2.12 të kontratës kur e ka pranuar makinën e vjetër dhe të përdorur, ngase qëllimi i kontratës dhe i ftesës për aplikim për grante ka qenë që përfituesi ta pranojë vetëm makinën e re dhe të papërdorur. Kur kontrata merr formën e prerë *pacta sunt servanda*, fuqia obliguese e detyrimeve që rrjedhin prej saj për palët është e njejtë me fuqinë obliguese të detyrimeve që rrjedhin nga ligji. Në qoftë se pjesëmarrësit në marrëdhëniet kontraktuese, nuk respektojnë dispozitat e kontratës së plotfuqishme, sanksioni është anulim i kontratës. Nisur nga kjo, Tribunali i Arbitrazhit nuk e ka pranuar pretendimin e paditësit se i padituri ka bërë shkelje

të kushteve të kontratës kur e ka anuluar kontratën, sepse me nenin 3.5 të kontratës është përcaktuar se Fondi mund ta ndërpresë këtë marrëveshje në çfarëdo kohe duke lajmëruar me shkrim përfituesin në rast se përfituesi nuk përmbush obligimet e caktuara paraprakisht. Poashtu, Tribunali i Arbitrazhit është bazuar edhe në nenin 12 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë nen është paraparë që në krijimin e marrëdhënieve të detyrimit dhe në realizimin e të drejtave dhe të detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit janë të detyruar t'i përmbahen parimit të ndershmërisë dhe ndërgjegjësisë.

Tribunali i Arbitrazhit ka ardhur në përfundim se i padituri mban detyrimin e kthimit të shumës (10%) prej 2.650,00 € të kontributit personal paditësit, meqë ky detyrim rrjedh nga dispozita e nenit 2.12 të kontratës së lidhur në mes të palëve. Mosbashkëpunimi dhe mostregimi i llogarisë bankare nga ana e paditësit, nuk e liron të paditurin nga lirimi i kthimit të këtij depoziti, paditësit. Në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyimore, do të konsiderohej se e paditura e ka përmbushur obligimin e vet, sikur mjetet e depozitit të kontributit personal të paditësit t'i kishte deponuar në gjyq. Nga fakti që i padituri nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të tillë, dhe vazhdon edhe më tej t'i mbaj mjetet në llogarinë e tij bankare, rrjedh se i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin e vet sa i përket kthimit të shumës 2.650,00 € të zvogëluar 10% tek paditësi, andaj detyrimi i kthimit të këtyre mjeteve është i bazuar në ligj. Mirëpo, Tribunali i Arbitrazhit nuk e ka detyruar me këtë vendim të paditurin që t'ia kthej të paditurit këto mjete, për shkak se kërkesa për kthimin e këtyre mjeteve nuk ishte përfshirë në kërkesëpadinë e paditësit. Por kjo, nuk e përjashton të drejtën e paditësit që kthimin e këtyre mjeteve ta realizojë me marrëveshje me të paditurin, aq më pak kur një gadishmëri e qartë për bashkëpunim u shpreh nga i padituri gjatë procesit të arbitrazhit.

Tribunali i Arbitrazhit ka pranuar si të drejtë konkludimin e ekspertit të aktuaristikës se anulimi i kontratës nuk ka pasur efekt në afarizmin e paditësit dhe e ka refuzuar kërkesëpadinë për fitimin e humbur në shumën prej 3,000.00 €. Tribunali i Arbitrazhit nuk e ka pranuar pretendimin e paditëses se e paditura me shkëputjen e njëanshme të kontratës i ka shkaktuar dëm material paditësit në shumën prej 3,000.00 € në emër të fitimit të humbur, pasi kjo nuk u provua me prova dhe fakte relevante nga paditësi. Kontrata në fjalë nuk përmbante ndonjë dispozitë e cila do t'i mundësonte përfituesit, pranimin nga furnitori të makinës së vjetër dhe të përdorur.

### **c) Çështjet e pagesës**

Pas shqyrtimit që nëse paditësi i ka përmbushur apo jo obligimet kontraktuese të parapara me nenin 2.12 të kontratës kur e ka pranuar makinerinë e vjetër dhe të përdorur, Tribunali erdhi në përfundim që paditësi duhet të sanksionohet me 10% të shumës prej 2.650,00 € që ka kontribuar në blerjen e makinerisë, pasi që makineria nuk i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në kontratë. Poashtu, pas shqyrtimit që nëse ndërprerja e menjëhershme e kontratës nga ana e të paditurit, ka pasur apo jo ndikim në afarizmin e paditësit, Tribunali i Arbitrazhit erdhi në përfundim që i padituri nuk duhet të paguaj shumën prej 3,000.00 € siq është kërkuar në kërkesëpadinë e paraqitur nga paditësi, sepse ndërprerja e menjëhershme e kontratës nuk ka shkaktuar dëm në afarizmin e paditësit.

## **2. Vendimi**

Tribunali i Arbitrazhit ka vendosur që i padituri nuk mban detyrim për rivendosjen e gjendjes përpara anulimit të kontratës dhe zhdëmtimin e fitimit të humbur paditësit në shumën prej 3,000.00 €. Nga kjo rrjedh se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në ligj dhe, si e tillë, është refuzuar nga Tribunal i Arbitrazhit. Tribunali i Arbitrazhit, duke u bazuar në faktin se pala paditëse e ka fituar kontestin ndaj palës së paditur, konform dispozitave ligjore të përmendura, mori vendim që shpenzimet procedurale t'i ngarkohen palës paditëse.